1 VIDEO/ Ngjarje e frikshme para fjalës - Laçi, shembet mëllonë i studiondi 'Adush Muça'
2 Me shkop bejsbolli në duar dha shka ndiqej nga grupi personash për ta 'kapur' atë që e kishte sulmuar, dënohet me 22 muaj burg 23-vjeçari shqiptar në Angli
3 Tjetërsimi i pronave në Ligjoren e Kuvo bëhët, arrestohet zyrtari në Lezhë! Akuzohet për shpërdorim detyre
4 Ekspertiza e munguar e Sorkës, që u lë pafajësisht disa vite njerëzve konspirative
5 FOTO,A,JM/ 'Kënaqësia e prindërve' Hanna mori shkëputjen e Merkut, dërgohet kryeministrit për ekonomitë e financat

Kronikë

Fushë-Krujë/ U bënë tapë në lokal dhe u konfliktuan, i riu plagos shokun e më pas veten! Arrestohet autori, pranga edhe pronarit të lokalit, fshehu armën e krimit

Një konflikt i çastit mbrëmjen e së shtunës në Tapizë të fshatit Qerekë të Fushë-Krujës ka vijuar me dy plagosje me armë zjarri.

Foto Autoriteti

Redaksia
11 Dhjetor, 09:26 | **Përditësimi: 11 Dhjetor, 13:09**

FUSHË-KRUJË- Një konflikt i çastit mbrëmjen e së shtunës në Tapizë të fshatit Qerekë të Fushë-Krujës ka vijuar me dy plagosje me armë zjarri. Ngjarja ka ndodhur në 01.00 pas mesnate.

Teksa ishin duke festuar 25-vjetorin e Lorenc Canit në lokalin e tij dy nga 6 personat prezentë janë përfshirë në një konflikt.

LEXO EDHE:
Reshjet e dendura të shiut, lumi Ishëm në Fushë-Krujë del nga shtrati! Përmbyten qindra hektarë tokë, izolohen disa familje në Murqinë (VIDEO)

Xhentil Sefa dhe Lorenc Cani në gjendje të dehur janë përfshirë në një konflikt dhe Sefa ka plagosur Canin me armë zjarri e më pas veten.

3 persona u vunë në pranga të policisë në Fushë-Krujë, pas plagosjes me armë zjarri të Lorenc Canit në një lokal në Tapizë.

Xhentil Sefa 25 vjeç është arrestuar nga policia, pasi plagosi me arme shokun e tij Lorenc Cani, teksa po festonin ditëlindjen e këtij të fundit në një lokal në Qerekë. I riu dyshohet se në gjendje të dehur ka nxjerrë armën dhe ka qëlluar në drejtim të shokut të tij Lorenc Cani, e më pas është vetplagosur në dorë.

Policia po ashtu ka arrestuar edhe Flogert Kallari, edhe ky shok i dy të rinjve, për moskallëzim të krimit. Në pranga ka rënë edhe Hygert Muja, pronar i lokalit, për veprën penale "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës". Muja rezulton se pronari i lokalit ku ndodhi ngjarja, ka fshehur armën e krimit, ka hequr gëzhojat nga vendngjarja dhe ka prishur vendin e ngjarjes.

Dy prej shokëve që kanë qenë në tavolinë kanë kallëzuar krimin, pra kanë deklaruar në polici ngjarjen dhe janë lënë të lirë. Autori është pronar i lokalit dhe një prej shokeve që nuk kanë kallëzuar krimin dhe ka fshehur provat janë arrestuar.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 10:03

EMRAT/ Po festonin ditëlindjen, i riu plagos shokun në Tapizë e më pas veten, arrestohet nga policia! Pranga edhe pronarit të lokalit, fshehu armën e krimit

3 persona janë vënë në pranga të policisë në Fushë-Krujë, pas plagosjes me armë zjarri të Lorenc Canit në një lokal në Tapizë.

Xhentil Sefa 25 vjeç është arrestuar nga policia, pasi plagosi me arme shokun e tij Lorenc Cani, teksa po festonin ditëlindjen e këtij të fundit në një lokal në Qerekë. I riu dyshohet se në gjendje të dehur ka nxjerrë armën dhe ka qëlluar në drejtim të shokut të tij Lorenc Cani, e më pas është vetplagosur në dorë.

Policia po ashtu ka arrestuar edhe Flogert Kallari, edhe ky shok i dy të rinjve, për moskallëzim të krimit. Në pranga ka rënë edhe Hygert Muja, pronar i lokalit, për veprën penale "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës". Muja rezulton se pronari i lokalit ku ndodhi ngjarja, ka fshehur armën e krimit, ka hequr gëzhojat nga vendngjarja dhe ka prishur vendin e ngjarjes.

Njoftimi i policisë

Plagosi me armë zjarri, një shtetas (shok i tij) dhe më pas veten, vihet në pranga 25-vjeçari.

Në pranga edhe pronari i lokalit ku ndodhi ngjarja, për prishje të vendit të ngjarjes dhe fshehje të provave.

Arrestohet edhe një shtetas tjetër (shok i shtetasve të plagosur), për moskallëzim të krimit.

Sekuestrohet në cilësinë e provës materiale, arma e zjarrit pistoletë me të cilën u krye plagosja.

Specialistët për Hetimin e Krimit të Komisariatit të Policisë Krujë kanë arrestuar në flagrancë shtetasin Xh. S., 25 vjeç, për veprat penale "Vrasja", mbetur në tentativë dhe "Mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyese dhe e municionit luftarak".

Gjithashtu, u arrestua në flagrancë shtetasi H. M., 24 vjeç, pronari i lokalit ku ndodhi ngjarja, për veprën penale "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës".

Në vijim të veprimeve u arrestua në flagrancë edhe shtetasi: F. K., 28 vjeç, për veprën penale "Moskallëzimi i krimit".

Nga veprimet e para hetimore të kryera nga specialistët për Hetimin e Krimit në Komisariatin e Policisë Krujë, rezulton se këta shtetas ishin ulur së bashku në të njëjtën tavolinë, në lokalin e shtetasit H. M., në Qerek Tapizë.

Dyshohet se në gjendje të dehur, shtetasi Xh. S., ka nxjerrë një armë zjarri pistoletë dhe në rrethana ende të paqarta, ka plagosur shtetasin L. C. (shok i tij) dhe më pas është vetëplagosur në dorë. Të dy shtetasit e plagosur janë jashtë rrezikut për jetën.

Po nga veprimet hetimore rezultoi se shtetasi H. M., pronari i lokalit ku ndodhi ngjarja, ka fshehur armën e krimit, ka hequr gëzhojat nga vendngjarja dhe ka prishur vendin e ngjarjes.

Gurpi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë, po vijon punën për dokumentimin e plotë të kësaj ngjarjeje.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, për veprime të mëtejshme.

G.MO/M.Q./Shqiptarja.com

TAG: durres | fushe kruje | plagosje me arme zjarri | xhentil sefa | lorenc cani | flogert kallari | hygert muja

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH POLL
Sondazhi i ditës:
Tensionet në veri të Kosovës, a ka rrezik të shkohet deri në përplasje?
Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Moti i keq, përmbytje në disa fshatra në Lezhë dhe Fushë-Krujë! Rrëshqitje dheraish në rrugën e Komblit dhe në rrugën e Arbrit (VIDEO)
11 Dhjetor, 08:27

U kap me snajper e shotgun në portin e Durrësit, dëshmia e 53-vjeçarit nga Kosova: Jam i apasionuar pas koleksionimit të armëve
9 Dhjetor, 11:35


VIDEO+FOTO/ Tentoi të fuste armë në Shqipëri nga Porti i Durrësit, arrestohet 53-vjeçari nga Kosova! Kishte shotgun, 2167 fishekë dhe snajper në makinë
8 Dhjetor, 17:58

Balotazh edhe në 'Primaret' e Rithemelimit në Krujë, asnjë prej 11 kandidatëve nuk arrin të sigurojë 50% të votave
4 Dhjetor, 19:05

70 kg eksploziv, VIDEO me dron nga momenti kur IKMT shemb me shpërthim të kontrolluar 'Prestige Resort' në Kavajë! Reagon Irfan Hysenbellu: Hakmarrje politike
4 Dhjetor, 15:13

Në Krujë, numri më i madh i kandidatëve për primaret! 2 japin dorëheqjen
4 Dhjetor, 10:33

Durrës / Arrestohet 28-vjeçari, shndërroi dyqanin e materialeve të ndërtimit në dyqan hashashi
4 Dhjetor, 10:12

Primaret në Durrës, në garë Igli Cara dhe Armand Dervishin! Në Shijak, 700 anëtarë pritet të votojnë për 4 kandidatë
4 Dhjetor, 09:19

Vepra satirike 'Koloneli zog' e bullgarit Bojcev në skenën e teatrit të Durrësit! Doktori që viziton 'të marrët' dhe përfundon në çmendi
Besmira Xhaferasi
Aldo Mustafa
3 Dhjetor, 17:17

Kapet me pistoletë në lokal 43-vjeçari në Durrës, i dënuar më paré për tentativë vrasje dhe armë pa leje (VIDEO)
3 Dhjetor, 09:15

Plagoset me armë zjarri 38-vjeçari në Durrës, përfundon në gjendje të rëndë në spital! Në kërkim një i ri (EMRAT+VIDEO)
2 Dhjetor, 07:15

U kapën në flagrancë duke vënë baste sportive nga celulari, arrestohen 2 shtetas
1 Dhjetor, 14:03

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje